

VENDIM
Nr.655, datë 11.6.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS QENDËR ERSEKË TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Ersekë të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Ersekë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.1525, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Ersekë të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Ersekë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Ersekë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
112-114	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
115-133	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
134-143	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
144-150	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
151-152	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
153-176	Varrezat publike	Në pronësi
177-194	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
201-233,236-239,241-245	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
248-267	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-	Në pronësi

	kanalizimeve.	
300-302,304,305,307,308,310, 311,313,314,316,317,319,320 322,323,325,326,328,330,332, 334,336,337,339,340,342	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
303,306,309,312,315,318,321,324, 327,329,331,333,335,338,341,343 399	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi